



GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Faton Bajrami, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Ar-Tech Sh.P.K., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit N.H., avokat nga Suhareka, kundër debitorit Këshilli Prokurorial i Kosovës, me seli Prishtinë, rr. “Luan Haradinaj”, për shkak të borxhit sipas dokumentit të besueshëm – faturës, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.263/23 të dt. 04.08.2023, me datën 01.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Ar-Tech Sh.P.K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.263/23 të dt. 04.08.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.263/23 të dt. 04.08.2023, në dispozitiv e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Këshilli Prokurorial i Kosovës, dhe ka shfuqizuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.76/2023 i lejuar me datën 14.03.2023 nga Përmbaruesi Privat Liridon Tërshani me seli në Prizren.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit në tersi si e bazuar dhe të anulohet aktvendimi PPP.nr.263/23 të dt. 04.08.2023 dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Debitori ka parashtruar përgjigje në ankesë, me të cilën ka propozuar që të refuzohet ankesa e kreditorit dhe aktvendimi i atakuar të vërtetohet.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Ar-Tech Sh.P.K., me datën 14.03.2023, ka ushtruar propozim për përmbarim kundër debitorit Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të

dokumentit të besueshëm – Faturës me Nr.2/12/2022 të datës 02.12.2022, për shumën prej 4,734.60€.

Përmbartuesi Privat Liridon Tërshani me seli në Prizren, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me datë 14.03.2023, ka nxjerrë Urdhrin Përmbartimor P.nr.76/23, me të cilin ka caktuar përmbartimin sipas propozimit të kreditorit, në bazë të faturës së lartpërmendur, që konsiderohet dokument përmbartimor në bazë të nenit 29 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore (LPP).

Kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit, debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar Urdhrin në fjalë si të padrejtë dhe të pabazuar duke mos pranuar asnjë nga zyrtarë tanë këtë urdhrë për përmbartim, ku ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet në tërësi si e themeltë prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri përmbartimor.

Përfaqësuesi i kreditorit ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke i kundërshtuar thëniet e debitorit në prapësim si të pabazuar, duke i propozuar gjykatës që prapësimin ta refuzojë si të pabazuar dhe të vërteton urdhrin për përmbartim.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.263/23 të dt. 04.08.2023, në dispozitiv e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Këshilli Prokurorial i Kosovës, dhe ka shfuqizuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.76/2023 i lejuar me datën 14.03.2023 nga Përmbartuesi Privat Liridon Tërshani me seli në Prizren, duke vendosur me decidivishtë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parapara me nenin 182 par.2 të LPK, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Sa i përket pretendimeve për zbatimin e gabuar të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe për shkak të vërtetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin për përmbartim. Gjykata e shkallës së parë, me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin se dokumenti i besueshëm-fatura, në bazë të cilit organi përmbartues ka caktuar përmbartimin, nuk i plotëson tiparet e përmbartueshmërisë.

Me Nenin 29 par.1.3 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP) është paraparë që për përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm “*është fatura*” si dokument i besueshëm”, kurse neni 29 para. 3 të LPP-së përcakton “*Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Ndërsa me dispozitën e nenit 43 para. 4 të LPP-së përcaktohet se: “*Përmbartuesit privat nxjerrin urdhrin për përmbartueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbartueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbartueshmërisë së nxjerrë nga përmbartuesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbartimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbartuesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbartim nga*

përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim“. Gjithashtu sipas nenin 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”* Prandaj, në këtë rast rezulton se dokumenti përkatësisht Fatura me Nr.2/12/2022 të datës 02.12.2022, mbi bazën e të cilit është paraqitur propozimi për përmbarim dhe është lejuar urdhrin, nuk është pranuar nga debitori siç kërkohet edhe me dispozitën e nenit 21 dhe 29 të LPP-së.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se nga shkresat e lendes është vërtetuar se propozimi për përmbarim mbi bazën e të cilit është lejuar urdhrin përmbarimore, përmban të meta ngase në propozimin nuk është paraqitur dokumenti me të cilin është pranuar nga ana e debitorit, ashtu siç kërkohet edhe me nenin 21 dhe 29 të LPP-së, në të cilin parashihet se propozimi për përmbarim, nder të tjerash duhet të përmbaje nënshkrimin e pranuesit këtë rast debitorit apo të autorizuarve të tij.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka pranuar prapësimin me arsyet se urdhri për përmbarim është lejuar mbi bazën e faturave, por fatura nuk përmban as elementet për t’u cilësuar si faturë e rregullt apo dokument i besueshëm ngase nuk është pranuar nga debitori. Prandaj , Gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se fakti se fatura e lartcekur nuk i përmban elementet për të qene dokumenti i besueshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi të LPP-së.

Së këndejmi, Gjykata gjen se urdhri për përmbarim i caktuar nga përmbaruesi privat është lëshuar në bazë të një propozimi për përmbarim i cili nuk i ka plotësuar kushtet që kërkohen me Nenin 29, 38 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.1685/23, me datë 01.03.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami